

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Rasim Rasimi kryetar i kolegjit, Gani Zabeli dhe Ferit Osmani anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Ilmije Zeka procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit M.Rr. nga...Komuna e ..., për shkak të veprës penale ngacmimi, nga neni 186 par. 4 lidhur me par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkritazi me ankesën e të akuzuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Mitrovicë, P.nr.250/2015 datë 21.04.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me 21.06.2016, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa të akuzuarit M.Rr., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Mitrovicë, P.nr.250/2015 datë 21.04.2016, **Vërtetohet**.

## A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Mitrovicë, me aktgjykimin P.nr.250/2015 datë 21.04.2016 të akuzuarin M.Rr., e ka shpallë fajtor për veprën penale ngacmimi, nga neni 186 par. 4 lidhur me par. 1 të KPRK-së, për të cilën e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) €, të cilin është obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej 15 ditësh duke iu llogaritur nga 20 €, për një ditë burgu. Është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 €, në afatin prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. E dëmtuara E.R., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur i akuzuari M.Rr., vetëm për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarit t'i shqiptoj një dënim më të butë.

Prokurori i Apelit, me parashtrësën me shkrim PPA/II.nr.727/16 të datës 30.05.2016, ka propozuar që ankesa e të akuzuarit të refuzohet si e pa bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridike penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

### **Ankesa nuk është e bazuar.**

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, më gjithat Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës se nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të Ligjit Penal në dëm të të akuzuarit.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par.2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore.

Sa i përket vendimit për dënim, në ankesën e të akuzuarit pretendohet se gjykata e shkallës së parë edhe pse i ka përmendur rrethanat lehtësuese dhe rënduese, por theksohet se gjykata rrethanat për matjen e dënimit të cilat i ka paraqitur i ka mbivlerësuar dhe se veprimet inkriminuese të ekzistimit të veprës penale si shqetësimi dhe ankthi janë elemente të veprës penale e jo rregulla të përgjithshme për matjen e dënimit. Pretendohet se gjykata fare nuk e ka marrë parasysh gjendjen sociale – i papunësuar, gjendjen ekonomike tejet të dobët dhe që është shfrytëzues i ndihmës sociale, por ka marrë parasysh vetëm rrethanat rënduese. Gjithashtu thekson se veprën e ka pranuar vetëm që të mbyllet kjo çështje dhe mos t'i shkaktoj problem të dëmtuarës dhe që nuk ka dashur ta frikësoj të dëmtuarën apo t'i shkaktoj ankth, mirëpo kemi qenë në lidhje si çdo i ri i moshës së re në shkollë të mesme, mirëpo gjërat nuk shkuan siç menduam dhe lidhja jonë është ndërprerë dhe nuk e di se çfarë ka dashtë e dëmtuara nga unë duke më paraqitur kallëzim penal në stacion policor gjoja se nga unë kinse po ka frikë e ankth dhe po e shqetësoj. Duke pasur parasysh shkallën e përgjegjësisë penale është dashur të më shqiptohet një dënim kusht, ngase e kam bërë pranimin e fajësisë, jam i moshës relativisht të re dhe këtë vepër e kam kryer pa qëllim, jam i gjendjes së varfër ekonomike, jemi katër anëtarë të familjes ku asnjëri nuk punon, andaj i propozon kësaj gjykate që në prani të këtyre rrethanave të njëjtit t'i shqiptoj një dënim më të butë.

Kolegji penal i kësaj gjykate, duke shqyrtuar ankesën e të akuzuarit, si dhe duke shqyrtuar shkresat e lëndës, vlerëson se pretendimet ankimore në këtë drejtim, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat që ndikojnë në caktimin e llojit dhe

lartësisë së dënimit të parapara me dispozitat ligjore, ku si rrethana lehtësuese për të akuzuarin ka marrë për bazë faktin se i njëjti e ka pranuar fajësinë, është penduar për veprën të cilën e ka kryer si dhe deklarimin se nuk do të përsëris një vepër të llojit të njëjtë, sjelljen korrekte në gjykatë, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore dhe dëmin e shkaktuar të dëmtuarës. Gjykata e Apelit vlerëson se pranimi i fajësisë së të akuzuarit për veprën e kryer dhe rrethanat tjera lehtësuese të theksuara në ankesë, në raport me peshën e veprës së kryer penale, nuk e arsyetojnë pretendimin e të akuzuarit për shqiptimin e një dënimi më të butë siç pretendohet me ankesë, ngase në ankesë nuk ceket ndonjë rrethanë veçanërisht e re lehtësuese e cila nuk ka qenë objekt vlerësimi nga gjykata e shkallës së parë dhe e cila do të ndikonte në shqiptimin e një dënimi tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, andaj në prani të këtyre rrethanave, si dhe duke marrë parasysh mënyrën e kryerjes së veprës penale, kjo gjykatë vlerëson se dënimin të cilin i ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim duhet t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**

PA1.nr.684/2016 datë 21.06.2016

Bashkë. profesional  
Ilmije Zeka

Kryetar i kolegjit  
Rasim Rasimi

Anëtarët e kolegjit:

Gani Zabeli  
Ferit Osmani